Mos kërkoni dituri për t'u mburrur para dijetarëve, as për të diskutuar me mendjelehtët

Xhabir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Mos kërkoni dituri për t'u mburrur para dijetarëve, as për të diskutuar me mendjelehtët, e as që të bëni vende nëpër kuvende! Kushdo që e bën këtë, Zjarri (për të është meritor), Zjarri."

[Sahih] [Transmeton Ibn Maxhe]

Profeti ﷺ tërhoqi vërejtjen kundër kërkimit të diturisë për hir të mburrjes para dijetarëve dhe për t'u paraqitur si dijetar, ose për t'iu drejtuar dhe për të debatuar me mendjelehtët, ose për të mësuar në mënyrë që të zërë vend në kuvende dhe t'i jepet përparësi në to ndaj të tjerëve. Kushdo që e bën këtë, e meriton Zjarrin, për shkak të hipokrizisë dhe mungesës së sinqeritetit në kërkimin e diturisë për hir të Allahut.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/65047